

## BEKIMI I MATH I UJIT

*Kjo Sherbese behet nje here ne mot, me 5 te Jenarit, ne Vengjillen e Epifanise, pas Meshes se Shen Basilit. Nje ene me uje vihet mi nje Tryeze ne mes te Kishes me Kry-qin dhe me nje tufe besiloku. Prifti dhe Dhjaku, me Temjanicen dhe me llambadhe, dalin nga Alltari, dhe shkojne ne mes te Kishes, dyke kenduar ketó Tropare ne T. T. IV:*

*Zeri i Zotit po therrét mi újerat e thotë: Ejani te*

gjithe, merrni Shpirtin e urtesise, dhe friken e Perendise, Zotit Jesú Krisht qe u-fanés ne Jordán.

Sot bekohet natyra e újeve, sot lumi Jordán po çahet, edhe valat e tij qendrojne, dyke pare Zotin te pagezohet.

Si njerí ardhe nc lumc, o Mbrete ync Jesú Krisht, edhe kerkón te pagezohesh per mëkatat tonia, nga dora e Profetit o njeridashes.

**LAVDI E TANI:** Degjove zérin e Profetit, qe bertiste nc shkretetire, dhe ardhe me fytyren e një robi, dhe kerkove Pagezimin, o Zot i pamekatme. Te pane újerat edhe u-drothne, u-tremp edhe Pareréndesi, dhe thirri dyke thene: Si do ta ndriçonje diellin kandili? Si do ta dorezonje robi Kryezotin? Bekome mua dhe újerat o Shpetimtár, ti qe ngre mëkatat e botes.

*Ne keté mes, Prifti temjanis reth e rotull tryezes, pastaj thuhen Kendimet:*

**DHJAKU:** Urtesí.

**KENDONJESI:** Kendimi nga Profetia e Isaiut.

**DHJAKU:** Le te veme re.

**KENDONJESI:** Keshtú foli Zoti: Gezohu, o shkretetire, qe ke etje; gezohu, o shkretetire, dhe lulczó si trendafil. Dhe do te lulezonje shkretetira e Jordanit, edhe do te kendonje me ngazellím; edhe do ti jipet lavdí' e Libanit edhe nderi i Kamelit; edhe pòpulli im do ta shikonje lavdine dhe lartesín' e Perendise. Forcöhuni, o duar te dóbeta dhe gjunjë te pafuqishim. Shtýjini zemervégjelit, edhe thójuni: Kini kuraje, dhe mos kini frikë, se

ja Perendia ync do tjua çpagúanje; aý vete do te vinje, dhe do tju shpetonje. Ahere do te çelen syt' e te vérberve, dhe veshet e te shúrdhërve do te degjojne. Ahere do te këcenje i çali si dreri, dhe goja e nemecit do te bertase; se újerat edhe përronje do te derdhen nc shkretetire, dhe thatc. Dhe dheu i pauje do te behet moçale, dhe shkretetira do te buronje luménj; dhe atjé, ku kishin folene dranganjtë, do te kete bushe dhe gjethë. Dhe atjé do te kete një udhe te paqme, e cila do te quhet udha e shenjtë. Andéj nuke do te shkonje i paudhi; atjé do te baresin te arratisurit, edhe nuke do ta humbasin udhen. Atjé nuke do te kete luanc; atjé nuke do te kete egersira te këqja. Atjé do te baresin te shpetuarit edhe te ftúarit e Zotit. Dhe róberit do te çlirohen, edhe do te kthehen ne Sión me kenge brohorie; dhe do te gezohen, e do te ngazellohen me defrime; atjé nuke do te kete as dhembje, as helme, as psheretime.

**DHJAKU:** Urtesí.

**KENDONJESI:** Kendimi nga Profetia e Isaiut.

**DHJAKU:** Le te veme re.

**KENDONJESI:** Keshtú foli Zoti: Ju, qe kini etje, éjani per ujc; dhe ju, qe s' kini argjént, éjani te blini, te hani, e te pini vere dhe qumesht pa nonjé pagese. Persé harxhon argjendin tuaj per gjera, qe nuk ushqejne, dhe persé mundóheni per gjera, qe nuke ngopin? Degjómeni, dhe do te hani gjellet mé te mira, dhe shpirti juaj do te gezohet me defrime. Vérmani veshin, dhe éjani pas meje.

Degjómëni, dhe shpirti juaj do të rronje; dhe do tju jap mëshirat e shigurta te Davidit me dhjatë te përjetshime. Ja ku ju dhashtë një udheheqës e një kumandár si deshmím perpara pòpujve. Dhe do te ftosh kombe, që nuke te njohin; dhe popuj, që nuke ta dinc emrin, do te përikin pranc teje për Zotin Perendine tent edhe për Shenjin e Israelit, se aý te ka lavdruar. Kerkójeni Zotin taní që munt ta gjeni, dhe taní që eshte pranc. I paudhi le të heqë dore nga ligesite, dhe i pabesi le të largohet nga prapesite; dhe kthéhuni me Zotin, edhe aý do tju mëshironje; se aý i ndjen mëkatat pa kursim. Se mejtimet e mia, thotë Zoti, nuke janë si mejtimet túaja, dhe udhet e mia nuke janë si udhet túaja. Po sa lark eshte qelli nga dheu, aqë lark janë udhet e mia nga udhet túaja dhe mejtimet e mia nga mejtimet túaja. Se, sikunder shiu dhe debora zbresin nga qelli, dhe nuke kthehen prapë, po e vaditin dhencë për të mbire dhe për të lulezuar, dhe japid fare për të mbjellur dhe bukë për të ngrënë; ashtu edhe fjala, që del nga goja ime, nuke do më kthehet e zbrazur, po do ti mbaronje deshirat e mia dhe porrosít' e mia. Se do të dilni me ngazellim, dhe do të vazhdoni me paqe; se malet edhe brigjet do të kecejnë, dhe do tju presin me gas, dhe gjithë lisat e pyllit do të trokasin d'uartë. Dhe ne vendin e drizës do të mbinje qiparisi, dhe ne vendin e shkozës do të mbinje mirsina. Dhe ketó do ta lëçtin emrin e Zotit, edhe do të qendrojnë si shenja te përjetshime, dhe nuke

do të priten kurre.

**DHJAKU:** Urtesi.

**KENDONJESI:** Kendimi nga Profetia e Isaiut.

**DHJAKU:** Le të vëmë re.

**KENDONJESI:** Keshtu foli Zoti: Merrni uje me ngazellim nga pusi i shpetimit. Dhe do të thoni atë dite: Lavderójeni Zotin, thirreni emrin e tij; lajmerójuni kómbeve veprat e tij; kujtójeni, se u-lartesua emri i tij. Kendójeni emrin e Zotit, se ka bëre çudira, që i di bota e tere. Gezóhuni dhe brohoritni ju, që banoni në Sione, se u-lartesua Shenji i Israelit në mes të saj.

**DHJAKU:** Le të vëmë re.

**KENDONJESI:** Zoti eshte drita ime dhe shpetimi im. Zoti eshte forca e jetes sime.

**DHJAKU:** Urtesi.

**KENDONJESI:** Kendimi prej Letres se Pare se Palit per Korinthianet.

**DHJAKU:** Le të vëmë re.

**KENDONJESI:** Vellezër, nuke dua të mos dini se të gjithe áterit tane ishin nencë renë; dhe të gjithe shkuan nepër detin; dhe të gjithe u-pagezuan me anën e Moisiut në renë dhe në detin; dhe të gjithe héngrënë gjithatë gjelle shpirterore; dhe të gjithe pine gjithatë te pire shpirterore; se kanë pire nga shkembi shpirterór, që i pasonte; dhe aý shkemp ishte Krishti.

**KORI:** Alilluja, alilluja, alilluja.

**DHJAKU:** Urtesi, o të drejtë. Le ta degjojmë Ungjillin e Shenjte.

**PRIFTI:** Paqe të gjithëve.

**KORI:** Dhe me frymën tende.

**PRIFTI:** Këndimi prej Ungjillit të Shenjtë pas Markut.

**DHJAKU:** Le të vëmë re.

**PRIFTI:** M' atë kohë, Jesuj ardhë nga Nazareti i Galilec, dhe u-pagezua prej Joanit në Jordán. Dhe menjcherc, kur dilte nga uja, pá se qelli u-ça, dhe Shpirti zbriti mi koken e tij si një pullúmp. Dhe një zë ardhë nga qelli: Ti je im Bir i dashur, që më ke pëlqyer.

**KORI:** Lavdí më ty, o Zot, lavdí më ty.

*Pastaj Dhjaku thote Litanine e Madhe:*

**DHJAKU:** Më paqe le ti lútemi Zotit.

**KORI:** Meshiró, o Zot.

**DHJAKU:** Per paqen që lartazi, dhe per shpe-timin e shpírteve tona, le ti lútemi Zotit.

**KORI:** Meshiró, o Zot.

**DHJAKU:** Per paqen e tere botes, per mire-vajtjen e Kishëve te shenjta te Perendise dhe per bashkimin e te gjithave, le ti lútemi Zotit.

**KORI:** Meshiró, o Zot.

**DHJAKU:** Per Kryepeshkopin tone (*aksh*), per prifterine dhe dhjakerin' e nderuar më Krish-tin, per tere klerin dhe pòpullin, le ti lútemi Zotit.

**KORI:** Meshiró, o Zot.

**DHJAKU:** Që te shenjtërohet kjo uje me fuqinë, veperimin dhe permindodhjen e Shpirtit Shenjt, le ti lútemi Zotit.

**KORI:** Meshiró, o Zot.

**DHJAKU:** Që te dërgohet mi ketë uje hiri i çperblimit edhe bekimi i Jordanit, le ti lútemi Zotit.

**KORI:** Meshiró, o Zot.

**DHJAKU:** Që te bëhet kjo uje shërim i shpír-teve dhe i trúpeve dhe largim i gjithë fórcave armike, le ti lútemi Zotit.

**KORI:** Meshiró, o Zot.

**DHJAKU:** Që te bëhem bij dhe trashegimtarë te Mbreterisë qellore me pjesetimin dhe sperkat-jen e keti uji, le ti lútemi Zotit.

**KORI:** Meshiró, o Zot.

**DHJAKU:** Që te shpetojme prej çdo hidherimi, merie, reziku dhe nevoje, le ti lútemi Zotit.

**KORI:** Meshiró, o Zot.

**DHJAKU:** Perkrahna, shpetona, meshirona dhe rúajna, o Perendí, me hirin tent.

**KORI:** Meshiró, o Zot.

**DHJAKU:** Tëreshenjen, te pacinuaren, te permibekuaren, te lavderuaren, Kryezonjen tone, Hyjlíndesen dhe gjithenjé Virgjëreshen Marí dy-ke kujtuar me gjithe Shenjtoret, veten tone dhe njérjatrin dhe tere jeten tone Krishtit Perendí le tja pranojmë .

**KORI:** Ty, o Zot.

**PRIFTI:** Se ty te ka hie çdo lavdí, nder e adhu-rím, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e për-here dhe nc jetet e jéteve.

**KORI:** Amín.

*Pastáj Prifti kendón me ze te larte keté Uraté:*

PRIFTI: I math je, o Zot, dhe tē habíçime janë veprat e tua, dhe asnje fjale s' esht e mjaftë per te treguar çudirat e tua (3 here). Se ti i bcre tē gjitha nga e paqëna; se ti zbrite mi dhene, dyke marre fytyre robi; se ti e shpetove gjindjen njerezore nga tiraní e djallit; se ti i shenjterove valat e Jordanit; dhe ti i dermove kreret e drangonjve, që folesonin atjé. Ti pra, o Mbret njeridashes, eja dhe taní me përmindodhjen e Shpirtit Shenjt, edhe shenjteroje keté uje (3 here). Ep-i hirin e çperblimit edhe bekimin e Jordanit; dhe falu shenjterimin, bekimin, paqesimin, shëndetin dhe ndjesen e mëkâtave tē gjithëve sa e prekin, a lyhen, a e kungojnë. Kujtó, o Zot, Kryepeshkopin tonec (*aksh*); tere prifterinc dhe dhjakcerinc më Krishtin; pöpullin, që rri rotull; vellézerit tanë, që nukë ndodhen; dhe meshiroji tē gjithe me dhëmpsherine tende. Që te lavderohet emri yt i shenjtë, i Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Paqe tē gjithëve.

KORI: Dhe me frymen tende.

DHJAKU: Kreret tona Zotit le tja unjim.

KORI: Ty, o Zot.

*Pastáj Prifti thote me ze te unjur keté Uraté:*

PRIFTI: Verna veshin, dhe degjona, o Zot, që dignove tē pagezohesh në Jordán, dhe ti shenjtë-

rósh újérat; bekona tē gjithe né, që po únjemi përpara teje si sherbetoret e tu; dhe vlerësona tē marrim shenjterimin tent me pjesëtimin dhe sperkatjen e keti uji; dhe na u-bëftë, o Zot, për sherim tē shpirtit e tē trupit.

Se ti je shenjterimi i shpírteve dhe i trúpeve tona, dhe ty tē dërgojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e perhere dhe né jetet e jéteve.

KORI: Amín

*Pastáj Prifti e bekón ujen per se treti, dyke pagezuar Kryqin, dhe thote keté Tropár ne T. I.:*

Kur pagezóheshe në Jordanin o Zot per né, ahere falja e Shen Trinise kudó u-çfaq, se zer' i Prindit po na deshmonte per ty fáqeza, dhe Bir te dashur tē tij po tē quante; edhe Shpirti i Shenjtë si një pullúmp, vertetonte çdo fjale me shiguri. Ti që u-fanese Krisht Perendí, dhe ndriçove boten lavdí me ty.

*Pastáj Prifti e sperkát tere pöpullin, dhe besniket e pershëndoshin Kryqin. Pastáj kendohet Shkurtorja ne T. IV:*

U-fanese me lavdí, ne tere boten, edhe drita jote sot, na u-shënu me çudí; pra tē hymnojmë me kupetim: Ardhe u-duke, o drít' e paafrú-arshme.

*Pastáj jipet Nafora, dhe behet Perleshimi i Shkurter:*

Krishti, Perëndia yne i vertete, që u-pagezua prej Joanit në Jordán per shpëtimin tonec, me

nërmjetimet e Shen Marise dhe të gjithë Shenjtó-reve, na meshiroftë, dhe na shpetofte si i mirë dhe njeridashës.